



UN
DP

PROGRAMI I KOMBEVE TË BASHKUARA PËR ZHVILLIM

PRILL 2022

Photo: ©UNDP

Dokument Informues për Rrjetin Global të Politikave të UNDP-së

Kontrolli i armëve të vogla – Çështja e integritimit gjinor

Përvoja nga Evropa Juglindore

Përgatitur nga Dragan Bozanic¹

Armët e vogla² dhe gjinia janë të lidhura ngushtësisht me njëra-tjetrën. Një gamë e gjerë hulumtimesh në Evropën Juglindore kanë dokumentuar mënyrën se si normat dhe rolet gjinore, duke u ndërthurur në mënyrë komplekse me faktorë të tjerë, mund të nxisin kërkesën për armë të vogla dhe të krijojnë modele të keqpërdorimit të tyre. Për më tepër, disa rreziqe specifike me të cilat përballen gratë dhe burrat lidhur me keqpërdorimin e armëve të vogla, veçanërisht sa i takon formave dhe nivelit të ekspozimit të tyre ndaj dhunës me armë, janë të lidhura me aspektet gjinore. Nga ana tjetër, përhapja e gjerë dhe keqpërdorimi i armëve të vogla përkeqësojnë pabarazitë gjinore ekzistuese, në situata konflikti ose jo, *si dhe rrisin pabarazitë e pushtetit ndërmjet grave dhe burrave*,³ çka është më e dukshme në kontekstin e dhunës ndaj grave. Këto modele janë tejet të qëndrueshme dhe deri para pak kohësh, përgjigjet operacionale dhe me politika kanë qenë të vakëta dhe në përgjithësi nuk kanë arritur të trajtojnë siç duhet lidhjet midis gjinisë dhe armëve të vogla. Megjithatë, institucionet në Ballkanin Perëndimor, me mbështetjen e UNDP SEESAC, po bëjnë gjithnjë e më shumë përpjekje për të integruar perspektivën gjinore në kuadrot për kontrollin e armëve, duke ofruar një model që jep zgjidhje përmes politikave me përgjegjshmëri gjinore më të lartë dhe që kontribuon për krijimin e komuniteteve më të qëndrueshme. Bazuar në këto përvoja, ky dokument informues ofron një përmbledhje të evidencave kyçe që kanë përvijuar debatet mbi kontrollin e armëve të vogla në rajon dhe që e kanë bërë më të thjeshtë argumentimin e integritimit të aspekteve gjinore në kontrollin e armëve të vogla. Ky dokument përshkruan më tej strategjitë praktike për integrimin gjinor dhe nënvizon rëndësinë e analizës gjinore në përmirësimin e përgjegjshmërisë gjinore në kontrollin e armëve. Së fundi, në dokument diskutohen implikimet politike të përfshirjes së perspektivave gjinore në politikat për kontrollin e armëve, si dhe planifikimi i së ardhmes.

Konteksti

Përhapja në shkallë të gjerë dhe keqpërdorimi i armëve të vogla dhe të lehta (referuar në vijim si AVL) janë pranuar gjerësisht si kërcënime serioze ndaj paqes dhe sigurisë ndërkombëtare, të cilat nxisin paqëndrueshmërinë dhe ndikojnë negativisht në zhvillimin e përgjithshëm social dhe ekonomik.⁴ Për më tepër, përhapja e gjerë e AVL-ve të jashtëligjshme dhe e municioneve të tyre konsiderohet si një aspekt kyç që nxit konfliktet dhe krimet rajonale.⁵

Si pasojë e historikut të konflikteve të armatosura apo trazirave në vitet 1990, Ballkani Perëndimor vijon të përballet me sfida të shumta lidhur me zotërimin e jashtëligjshëm, keqpërdorimin dhe trafikimin e armëve të zjarrit, gjë që mund të ketë një efekt destabilizues mbi situatën në rajon. Krahas kësaj, sfidat lidhur me kontrollin e armëve të vogla vazhdojnë të evoluojnë, si dhe po shfaqen kërcënime të reja. Kjo situatë kërkon një politikë gjithëpërfshirëse dhe fleksibël, si dhe një qasje operacionale.

Paralelisht, janë ndërmarrë përpjekje afatgjata për trajtimin e këtyre sfidave të shumta. Që në vitin 2002, Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim, nëpërmjet Zyrës Qendrore të Evropës Lindore dhe Juglindore për Kontrollin e Armëve të Vogla dhe të Lehta (UNDP SEESAC, referuar në vijim si SEESAC) dhe me mbështetjen e Bashkimit Evropian, ka punuar për forcimin e kapaciteteve të grupeve të interesit në nivel kombëtar dhe rajonal për të kontrolluar dhe reduktuar përhapjen dhe keqpërdorimin e armëve të vogla dhe të lehta, për të rritur barazinë gjinore, si dhe për të lehtësuar bashkëpunimin rajonal, duke kontribuar kështu në përmirësimin e stabilitetit, sigurisë dhe zhvillimit në Evropën Juglindore dhe Lindore. Në kuadër të mandatit të saj, SEESAC ofron mbështetje 360 gradë për institucionet, duke filluar

nga shkatërrimi i armëve, përmirësimi i sigurisë së depove dhe menaxhimit të stoqeve, markimi dhe gjurmimi i armëve, si dhe mbajtja e regjistrave rreth tyre, mbështetje për zhvillimin e politikave, fushata për rritjen e ndërgjegjësimit për reduktimin e zotërimit të jashtëligjshëm dhe keqpërdorimit të armëve të zjarrit, e deri te hulumtimet dhe mbledhja e të dhënave.

Në dekadën e fundit është bërë progres i konsiderueshëm në rajon sa i takon krijimit të kuadrove ligjorë, politikë dhe institucionale për kontrollin e AVL-ve. Për shembull, në të gjithë rajonin janë ngritur⁶ Komisionet e AVL-ve, në cilësinë e organeve ndërinstitucionale përgjegjëse për hartimin e politikave dhe koordinimin e përgjithshëm të zbatimit të kontrollit të armëve të vogla. Së fundmi, autoritetet kanë miratuar Udhërrëfyesin për një zgjidhje të qëndrueshme për kontrollin e armëve në Ballkanin Perëndimor. Udhërrëfyesi synon ta bëjë Ballkanin Perëndimor një rajon më të sigurt dhe një eksportues të sigurisë, ku ekzistojnë mekanizmat gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme, të harmonizuara plotësisht me Bashkimin Evropian dhe standardet e tjera ndërkombëtare, për të identifikuar, parandaluar, proceduar dhe kontrolluar zotërimin e jashtëligjshëm, keqpërdorimin dhe trafikimin e armëve të zjarrit, municioneve dhe eksplozivëve. Udhërrëfyesi është hartuar me mbështetjen teknike të SEESAC, nën kujdesin e Francës dhe Gjermanisë, si dhe në konsultim me BE-në dhe të gjithë aktorët e tjerë përkatës. Udhërrëfyesi i kushton një rëndësi të veçantë barazisë gjinore dhe bën thirrje për integrim të plotë të perspektivës gjinore dhe përfaqësim të balancuar të grave në kontrollin e AVL-ve. Sa i takon implementimit, Udhërrëfyesi është zbatuar përmes planeve të veprimit që janë hartuar dhe miratuar në secilin juridiksion të Ballkanit Perëndimor.

Natyra gjinore e armëve të zjarrit


Rritja e gamës së hulumtimeve ka ofruar evidencë të shumta lidhur me natyrën thellësisht gjinore të armëve të zjarrit dhe ka dokumentuar disa forma të lidhjes midis aspekteve gjinore dhe armëve. Të dhënat e disponueshme tregojnë se aspektet gjinore të armëve të zjarrit mund të gjurmohen për çështje të tilla si pronësia e armëve të zjarrit, duke përfshirë për lidhjet ndërmjet normave të burrërisë dhe kërkesës për armë zjarri, ndikimet e ndryshme të keqpërdorimit të armëve të zjarrit te gratë dhe burrat, roli i armëve të zjarrit në dhunën me bazë gjinore dhe dhunën ndaj grave, dallimet në përvojat dhe qëndrimet kundrejt armëve të zjarrit, si dhe natyra gjinore e procesit të hartimit të politikave dhe e debatit.⁷

Siç dokumentohet nga disa studime kërkimore të kryera nga SEESAC⁸, situata konkrete në rajon është e lidhur ngushtësisht me këto modele gjinore.

1. **Pronësia e armëve të zjarrit ka natyrë thellësisht gjinore.** Në Evropën Juglindore (në vijim referuar si EJT), burrat zotërojnë 97,2% të të gjitha armëve të zjarrit në pronësi të ligjshme, ndërsa gratë zotërojnë vetëm 2,8%.⁹ Vetëm në vitin 2016, 81 372 burra dhe 2037 gra (përkatësisht 97,6% dhe 2,4%) morën leje të reja, çka tregon vazhdimin e dominancës së burrave në këtë drejtim. Deri në njëfarë mase, dallimet gjinore reflektohen edhe në qëndrimet ndaj pronësisë së armëve të zjarrit. Të dhënat e anketimit rajonal të kryer në vitin 2017 treguan se burrat kanë dy herë më shumë gjasa se gratë për të pranuar se do të zotëronin një armë, përkatësisht 35,3% dhe 18,7%. Kjo është veçanërisht e vërtetë për burrat e grupmoshës më të re dhe më të vjetër, të cilët janë më të prirur të zotërojnë një armë zjarri krahasuar me burrat nga grupmoshat e tjera. Sa i takon grave, duhet të theksohet se edhe pse një përqindje e

konsiderueshme e tyre pohuan se do të zotëronin një armë, ato përbënin vetëm një përqindje të vogël të aplikanteve për leje të reja.

Figura 1: Pronësia e armëve të zjarrit në EJL, sipas seksit, 2016



Burimi: SEESAC, 2019


Gjithashtu, burrat kishin më shumë gjasa se gratë që të përmendnin “traditën” si arsye për zotërimin e një arme zjarri. Deri në njëfarë mase, kjo mund të jetë e lidhur me perceptimin klasik të burrërisë, sipas të cilit armët e zjarrit zënë një vend të veçantë apo madje mund të kenë luajtur një rol gjatë periudhës së kalimit në moshën e pjekurisë.¹⁰ Për shkak të këtyre modeleve thellësisht gjinore të kërkesës për armë zjarri, është konstatuar se është e nevojshme të eksplorojnë nocionet e burrërisë dhe roli i armëve në kulturën e meshkujve, si dhe të zhvillohen strategji praktike për të eliminuar lidhjet midis tyre.¹¹ Për më tepër, është argumentuar sepuna për kontrollin e AVL-ve mund të cenohet nga rëndësia që kanë armët e zjarrit në përcaktimin e konceptit gjinor të burrërisë.¹²

2. Krahas zotërimit të armëve të zjarrit nga civilët, **burrat mbizotërojnë edhe në profesionet e sektorit të sigurisë dhe në veprimtaritë që përfshijnë armët e zjarrit.** Në EJL, në vitin 2016, burrat përbënin 91,2% të të gjithë punonjësve të sektorit të sigurisë të autorizuar për të mbajtur armë zjarri, ndërsa gratë vetëm 8,8%. Këto dallime shërbejnë edhe si tregues të nënpërfaqësimit të grave në sektorin e sigurisë. Pavarësisht rritjes së përfshirjes së grave, ky sektor vijon të mbetet thellësisht i dominuar nga burrat. Për më tepër,

burrat mbizotërojnë në veprimtari të tilla si gjuetia dhe shenjëtaria, të cilat shoqërohen me akses të vazhdueshëm tek armët e zjarrit.

3. **Modelet e dhunës me armë kanë natyrë thellësisht gjinore dhe autorët e kësaj lloji dhune janë kryesisht burra.** Në vitin 2020, burrat përbënin 98% të autorëve¹³ të incidenteve me armë zjarri, çka konfirmon modelet e dokumentuara më parë. Dhuna me armë e kryer nga burrat lidhet gjithashtu me moshën. Meshkujt e rinj në moshë kanë më tepër gjasa që të keqpërdorin armët e zjarrit në krahasim me burrat e grupmoshave të tjera. Vetëm në vitin 2020, burrat e grupmoshës 19-35 vjeç përbënin thuajse gjysmën (48,7%) e të gjithë autorëve të incidenteve me armë zjarri. Për sa i përket kontekstit të keqpërdorimit të armëve të zjarrit, kryesisht burrat i kanë keqpërdorur ato gjatë veprimtarive kriminale apo në mosmarrëveshjet ose grindjet në publik, përkatësisht 42,7% dhe 26,6%.


Figura 2: Autorët e incidenteve me armë zjarri në EJL, sipas seksit, 2016



Burimi: SEESAC, 2019

4. **Armët e zjarrit kanë ndikime të ndryshme te gratë dhe burrat.** Burrat kanë shumë më tepër gjasa se gratë që të bien viktima të keqpërdorimit të armëve të zjarrit. Në EJL, burrat përbëjnë 83,8% të viktimave të vrasjeve me armë zjarri, ndërsa gratë 16,2%.¹⁴ Krahas shpërndarjes së ndryshme për sa i përket viktimave, ekziston gjithashtu një mospërputhje e dukshme në modelet e viktimizimit të grave dhe burrave në kontekstin e dhunës me armë zjarri.

Figura 3: Viktimat e vrasjeve me armë zjarri në EJL, sipas seksit, 2016




Burimi: SEESAC, 2019

5. **Dhuna me armë kundër burrave ndodh kryesisht në kontekste kriminale, nga mosmarrëveshjet në publik dhe nga të shtënat për shkaqe të papërcaktuara.** Një analizë e kohëve të fundit¹⁵ ka treguar se nga totali i burrave të vrarë me armë zjarri në EJL, 31% ishin vrarë nga të shtëna për shkaqe të papërcaktuara, në pritje të hetimit të mëtejshëm; 27,2% ishin vrarë në kontekste kriminale të lidhura me veprimtari të kriminit të organizuar, grabitje me armë etj.; 25,2% ishin vrarë në mosmarrëveshje në publik dhe 16,5% ishin vrarë nga një familjar mashkull.

6. **Gratë përbëjnë shumicën e viktimave të dhunës me armë zjarri në kontekstin e dhunës në familje.** Burrat kanë më shumë gjasa që t'i keqpërdorin armët e zjarrit se sa të bien viktima të tyre, ndërsa gratë kanë 10 herë më shumë gjasa të jenë viktima sesa autore të incidenteve me armë zjarri. Ky përfaqësim joproporcional i grave mes viktimave të dhunës me armë zjarri lidhet kryesisht me përdorimin e armëve të zjarrit në kontekstet e dhunës në familje dhe dhunës nga partneri intim. Hulumtimet e mëparshme¹⁶ të realizuara nga SEESAC kanë dokumentuar se vrasjet e kryera nga një anëtar i familjes janë forma më e përhapur e vrasjeve të grave në EJL dhe se gratë, ndryshe nga burrat, janë të rrezikuara veçanërisht nga dhuna nga partneri intim (Figura 4). Zakonisht, armët e zjarrit janë mjete i zgjedhur për t'u përdorur në kontekstet e dhunës në familje. Gjatë periudhës 2012-2016, 37,7% e vrasjeve të grave të kryera nga një anëtar i familjes janë kryer me armë zjarri. 36,5% e grave të vrara nga një familjar janë vrarë me armë zjarri, ndërsa 43,5% e grave janë vrarë nga një partner intim. Sipas Platformës së SEESAC për Monitorimin e Dhunës me Armë, në vitin 2020 janë vrarë 23 gra nga familjarët e tyre, ose e thënë ndryshe katër gra më shumë se në vitin 2019, çka tregon se si kushtet specifike të pandemisë kanë rritur rrezikun që u kanoset grave nga keqpërdorimi i armëve të zjarrit në kontekstin e dhunës në familje dhe rrjedhimisht, pasojat vdekjeprurëse të armëve.

Figura 4: Viktimat e vrasjeve të kryera nga anëtarët e familjes/partnerët intimë në raport me numrin total të viktimave të vrasjeve, sipas seksit (2012–2016)



Burimi: SEESAC, 2019


Një analizë e kohëve të fundit ka treguar se incidentet me armë zjarri në kontekstin e dhunës në familje shkaktuan numrin më të lartë të vdekjeve me armë zjarri në vitin 2020, duke tejkaluar numrin e vrasjeve të raportuara në të gjitha llojet e tjera të incidenteve, duke përfshirë në kontekstin kriminal, nga mosmarrëveshjet në publik dhe nga të shtënat për shkaqe të papërcaktuara.¹⁷

Në të njëjtin vit, 92% e të gjitha grave të vrara me armë zjarri në EJK u vranë në kontekstin e dhunës në familje dhe 65% prej tyre u vranë nga partneri intim. Gjatë të njëjtës periudhë, nuk ka pasur asnjë burrë të vrarë me armë zjarri nga partnerja e tyre intime. Pavarësisht përdorimit të dukshëm të armëve të zjarrit në dhunën në familje, të dhënat e

pakta tregojnë se keqpërdorimi i armëve të zjarrit në dhunën në familje shpeshherë nuk raportohet në institucionet përkatëse dhe se historiku i dhunës në familje përdoret rrallë si arsye për refuzimin e miratimit të lejeve për armë zjarri.

- Vetëvrasjet me armë zjarri kanë natyrë thellësisht gjinore.** Gjatë periudhës 2012–2016, në EJK burrat përbënin 84,7% të viktimave nga vetëvrasjet me armë zjarri, ndërsa gratë 15,3%.¹⁸ Në vitin 2020 kanë ndodhur pesëmbëdhjetë vrasje-vetëvrasje, shumica e të cilave kanë ndodhur në kontekstin e dhunës në familje. Shumica e viktimave në këto incidente kanë qenë anëtarë të familjes dhe partnerë intimë ndërsa autorët kanë qenë kryesisht meshkuj.

Figura 5: Modelet e ndryshme gjinore të lidhura me armët e vogla në Evropën Juglindore



Burimi: SEESAC, 2019

Pikënisja - Kontrolli i armëve sipas qasjes “së verbër nga ana gjinore”

Pavarësisht aspekteve thellësisht gjinore të armëve të vogla, qasja mbizotëruese në kontrollin e armëve deri para pak kohësh kishte prirjen të ishte e “verbër nga ana gjinore” dhe nuk arrinte t’i përgjigjej siç duhej natyrës thellësisht gjinore të armëve të zjarrit. Hulumtimi i SEESAC i vitit 2016¹⁹ dokumentoi gjerësisht se perspektivat gjinore nuk ishin integruar në kontrollin e armëve dhe se aspektet gjinore rrallë bëheshin pjesë e debateve të përhapura rreth kontrollit të armëve që zhvilloheshin në rajon. Rrjedhimisht, aspektet gjinore ishin nën-prioritizuar ndjeshëm dhe nuk konsideroheshin pjesë thelbësore e zhvillimit të politikave për kontrollin e armëve. Në nivel praktik, politikat përkatëse nuk kanë arritur të identifikojnë lidhjet midis dhunës me armë dhe dhunës me bazë gjinore, ndikimin e ndryshëm të armëve të zjarrit të gratë dhe burrat,

si dhe rolin, e faktorëve gjinorë, duke përfshirë të nocioneve të veçanta të burrërisë, në nxitjen e kërkesës për armë zjarri dhe keqpërdorimin e tyre. Qasja “e verbër nga ana gjinore”, e cila përdoret për një fenomen thellësisht gjinor si keqpërdorimi i armëve të zjarrit, nuk mund t’i trajtojë siç duhet sfidat aktuale dhe ndikon negativisht tek efikasiteti i masave operacionale për uljen dhe parandalimin e dhunës me armë. Ky efekt është dokumentuar nga tendencat e vazhdueshme të vrasjeve të grave të kryera me armë zjarri dhe nga ekspozimi i meshkujve të rinj në moshë, autorë dhe viktimë, ndaj dhunës me armë. Për më tepër, rreziqet gjinore të lidhura me armët e vogla bëhen edhe më të vështira për t’u trajtuar për shkak të ndërveprimit me rreziqe të tjera, si evoluimi i formave të dhunës me bazë gjinore.

Po i njëjti hulumtim identifikoi faktorët që pengojnë integrimin e aspekteve gjinore në kontrollin e armëve. Për shembull, politikat për kontrollin e armëve janë zhvilluar zakonisht në mjedise institucionale të mbizotëruara nga burrat, ndërsa gratë, agjencitë e barazisë gjinore dhe organizatat e grave, të cilat mund të kontribuonin në gjetjen e zgjidhjeve me përgjegjshmëri gjinore, kanë qenë ndjeshëm të nënpërfaqësuar. Për më

tepër, integrimi i perspektivës gjinore mund të pengohet më tej nga njohuritë e pamjaftueshme dhe ndërgjegjësimi i ulët i vendimmarrësve dhe politikëbërësve rreth aspekteve gjinore të armëve të vogla. Kjo situatë është përkeqësuar nga mungesa e të dhënave të ndara sipas seksit dhe përdorimi i pamjaftueshëm i analizës gjinore në zhvillimin e politikave.

Përmbysja e tendencave–Strategjitë praktike për integrimin e aspekteve gjinore në kontrollin e armëve të vogla

Duke u mbështetur tek kjo bazë e gjerë evidencash, SEESAC, në bashkëpunim me Komisionet e AVL-ve në rajon, ndërmori një grup aktivitësh gjithëpërfshirëse për t'i përmbysur këto tendenca dhe për të trajtuar sfidat e identifikuar duke e vendosur perspektivën gjinore në qendër të procesit të hartimit të politikave.

Qasja gjithëpërfshirëse e zbatuar për rritjen e përgjegjshmërisë gjinore të masave për kontrollin e AVL-ve bazohet në katër shtylla të ndërlidhura:

1. Ngritja e kapaciteteve të institucioneve përgjegjëse për kontrollin e armëve me qëllim integrimin e perspektivës gjinore në punën e tyre

Për të lehtësuar krijimin e mjediseve institucionale që mundësojnë hartimin e politikave me përgjegjshmëri gjinore, nisi zbatimin e një game të gjerë aktivitësh të rëndësishme për ngritjen e kapaciteteve. Për këtë qëllim, u prezantua [Programi i trajnimit për aspektet gjinore \(GCP\)](#), qëllimi i të cilit është forcimi i kapaciteteve të kryetarëve të Komisioneve të AVL-ve për integrimin e perspektivës gjinore në hartimin e politikave për kontrollin e AVL-ve. Ky program synon të rrisë përgjegjshmërinë gjinore të institucioneve duke zhvilluar kompetencat dhe duke nxitur angazhimin enivellit të lartë drejtues.²⁰ Zbatimin e programit të trajnimit për aspektet gjinore në Evropën Juglindore e ka dëshmuar tashmë potencialin e tij transformues. Pjesëmarrësit kanë nisur zbatimin e një game të gjerë aktivitësh të lidhura me gjininë dhe kanë advokuar për integrimin e masave me përgjegjshmëri gjinore në strategjitë për kontrollin e AVL-ve. Për më tepër, këto [kurse të posaçme trajnimi mbi aspektet gjinore dhe AVL-të](#), të organizuara për përfaqësuesit e komisioneve të AVL-ve, kanë lehtësuar më tej integrimin e perspektivës gjinore.

2. Hulmtimet dhe mbledhja e të dhënave

Hulmtimet dhe ushtrimet për mbledhjen e të dhënave në rajon janë mbështetur në metodologjitë me ndjeshmëri gjinore, duke kontribuar kështu në rritjen e disponueshmërisë

së statistikave gjinore dhe të vizibilitetit të dimensionit gjinor të родовата димензија на контролата на оружјето.kontrollit të armëve. Kjo gamë e gjerë e produkteve të njohurive, ku përfshihen [anketimet për AVL-të, botimet me fakte të shpejta mbi gjininë dhe armët e vogladhe raportet e Monitorimit të Dhunës me Armë - "In Focus"](#), ofrojnë evidenca të bollshme që shërbejnë si bazë për zhvillimin e politikave për kontrollin e armëve. Në kuadër të axhendës më të gjerë të zhvillimit, gama e këtyre hulumtimeve ofron gjithashtu të dhëna rreth lidhjeve mes dimensionit gjinor të kontrollit të armëve dhe Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm, sidomos të OZhQ 5 - Barazi gjinore dhe OZhQ 16 - Paqe dhe drejtësi, institucione të forta.

3. Rritja e pjesëmarrjes së grave në procesin e hartimit të politikave për kontrollin e armëve

Janë bërë përpjekje të vazhdueshme për të siguruar përfaqësimin e ekuilibruar dhe pjesëmarrjen aktive të grave në kontrollin e armëve, me fokus të veçantë te nismat për ngritjen e kapaciteteve dhe rritjen e ekspertizës së grave në këtë fushë të dominuar tradicionalisht nga meshkujt. Kjo është mbështetur në përpjekjet afatgjata të SEESAC për rritjen e pjesëmarrjes së grave në sektorin e sigurisë.²¹ Për më tepër, janë ndërmarrë përpjekje pioniere për të mbështetur krijimin e bashkëpunimit midis Komisioneve të AVL-ve, agjencive të barazisë gjinore dhe OJQ-ve të grave.e.

4. Rritja e ndërgjegjësimit rreth lidhjeve midis aspekteve gjinore dhe armëve të vogla

Fushatat e synuara kanë vijuar të kontribuojnë në rritjen e ndërgjegjësimit rreth aspekteve gjinore të keqpërdorimit të armëve dhe efekteve të tyre negative të gratë dhe burrat. Si shembull të kohëve të fundit [mund të përmendim fushatën që synon të trajtojë lidhjet midis normave të burrërisë dhe armëve të zjarrit dhe t'i bëjë thirrje burrave që t'u japin fund praktikave të dëmshme të lidhura me armët e zjarrit](#). Për më tepër, [rrjeti i grave gazetare](#) po rrit ndërgjegjësimin mbi përhapjen e përdorimit të armëve të zjarrit në kontekstet e dhunës në familje.

Ndryshimi i panoramës së politikave–Drejt kontrollit të armëve me përgjegjshmëri gjinore

Në vitin 2021, SEESAC, në bashkëpunim me Komisionet e AVL-ve në rajon, realizoi një analizë gjinore në shkallë të gjerë të legjislacionit dhe politikave për kontrollin e armëve të vogla. Në pesë juridiksione të Ballkanit Perëndimor janë shqyrtuar në total 101 ligje, 113 akte nënligjore dhe 39 strategji e plane veprimi, në mënyrë që të vlerësohej përgjegjshmëria e tyre gjinore dhe të jepeshin rekomandime praktike për trajtimin e duhur të rreziqeve të lidhura me armët e zjarrit, me të cilat përballen gratë dhe burrat. Për këtë qëllim, u zhvillua një metodologji e posaçme për analizën gjinore të legjislacionit dhe politikave përkatëse. Vlerësimi i përgjegjshmërisë gjinore të legjislacionit u vlerësua kundrejt shqetësimeve kryesore gjinore që lidhen me armët e vogla:

- parakushtet ligjore dhe të politikave për integrimin e perspektivës gjinore në politikat dhe legjislacionin për kontrollin e armëve të vogla;
- pjesëmarrja dhe përfaqësimi i grave në zhvillimin dhe zbatimin e politikave/legjislacionit për kontrollin e armëve;
- lidhjet midis armëve të zjarrit dhe dhunës në familje, si dhe dhunës ndaj grave;
- përgjigjet ndaj aspekteve gjinore të kërkesës, përdorimit dhe keqpërdorimit të armëve të zjarrit, duke përfshirë lidhjet midis formave të burrërisë dhe armëve të zjarrit;
- praktiket e mbajtjes së regjistrave dhe mbledhjes së të dhënave me ndjeshmëri gjinore.

Analiza dokumentoi progresin e konsiderueshëm që kishin bërë institucionet në Ballkanin Perëndimor për sa i përket integritet të perspektivës gjinore në politikat për kontrollin e armëve të vogla si rezultat i aktiviteteve të lartpërmendura. Vlen të përmendet në veçanti rasti i strategjive dhe planeve të veprimit të miratuara rishitazi për zbatimin e Udhërrëfyesit, të cilat parashikojnë disa masa për:

- trajtimin e lidhjeve midis armëve të zjarrit dhe dhunës në familje;

- përgjigjen ndaj aspekteve gjinore të kërkesës, përdorimit dhe keqpërdorimit të armëve të zjarrit, duke përfshirë lidhjet midis formave sociale mbizotëruese të burrërisë dhe armëve të zjarrit;
- rritjen e pjesëmarrjes dhe përfaqësimit të grave në kontrollin e armëve;
- ngritjen e mëtejshme të kapaciteteve institucionale për integrimin e aspekteve gjinore dhe përmirësimin e praktikave të mbajtjes së regjistrave dhe mbledhjes së të dhënave me ndjeshmëri gjinore.

Për më tepër, janë bërë përpjekje të dukshme për të garantuar se ligjet për armët parandalojnë në mënyrë efikase përdorimin e armëve të zjarrit në kontekstin e dhunës në familje, si dhe për të garantuar progres në krijimin e kuadrove ligjore dhe të politikave për eliminimin e dhunës në familje. Gjithashtu, analiza konstatoi se këto kuadro nuk ishin domosdoshmërisht gjithnjë koherente dhe identifikoi mangësi lidhur me zbatimin e tyre në praktikë. Analiza hartëzoi gjerësisht parakushtet ligjore dhe të politikave për integrimin e aspekteve gjinore dhe pjesëmarrjen e grave në kontrollin e armëve të vogla. Për më tepër, u analizuan praktiket ekzistuese të mbajtjes së regjistrave për të identifikuar pikat hyrëse për mbledhjen e të dhënave me ndjeshmëri gjinore.

Analiza solli si rezultat një gamë të gjerë rekomandimesh për forcimin e përgjigjes ndaj aspekteve gjinore të armëve të zjarrit nëpërmjet masave ligjore dhe të politikave, veçanërisht lidhur me parandalimin e përdorimit të armëve të zjarrit në dhunën në familje. Gjetjet dhe rekomandimet shoqëruese janë përdorur tashmë në rishikimet e vazhdueshme të strategjive dhe planeve të veprimit për kontrollin e AVL-ve në Ballkanin Perëndimor.

Implikimet e lidhura me politikat—Si ndikon integrimi i aspekteve gjinore në përmirësimin e kontrollit të armëve të vogla dhe në qëndrueshmërinë e komunitetit

Zhvillimet në EJK kanë treguar se integrimi i perspektivës gjinore në kontrollin e armëve ka implikime të konsiderueshme të lidhura me politikat, të tilla si:

- Zgjeron objektin e axhendës për kontrollin të armëve.** Integrimi i aspekteve gjinore në politikat për kontrollin e armëve të vogla shërben si argument i fortë për integrimin e çështjeve që tradicionalisht nuk kanë qenë pjesë e debateve për kontrollin e armëve të vogla, si dhuna me bazë gjinore, nocioni i burrërisë ose pjesëmarrja e grave në kontrollin e armëve. Gjenerata e re e strategjive për kontrollin e AVL-ve që janë zhvilluar në mbarë Ballkanin Perëndimor, është shembull i spikatur i kësaj tendence.
- Eksponon natyrën thellësisht gjinore të dhunës me armë,** për sa i përket shkaqeve themelore të dhunës, formave të saj, dinamikave, autorëve dhe viktimave. Rrjedhimisht, integrimi i aspekteve gjinore thekson nevojën për marrjen e veprimeve dhe trajtimin e aspekteve gjinore të dhunës me armë si një parakusht për kontrollin efikas të armëve të vogla.
- Hedh dritë mbi lidhjet midis dhunës kundër grave dhe dhunës me armë.** Përfshirja e aspekteve gjinore në debatet për kontrollin e armëve thekson efektet negative që ka përhapja e armëve të zjarrit të siguria dhe mirëqenia e grave dhe dokumenton mënyrën se si armët e zjarritrisin pabarazitë e pushtetitndërmjet grave dhe burrave, sidomos në kontekstin e dhunës në familje. Për më tepër, thekson nevojën për koherencë më të madhe midis masave për kontrollin e armëve dhe përpjekjeve që synojnë eliminimin e dhunës në familje.
- Thekson nevojën për trajtimin e kontekstit më të gjerë të normave dhe roleve gjinore, në veçanti të nocioneve të veçanta të burrërisë në kontekstin e parandalimit të dhunës me armë dhe reduktimit të kërkesës për armë zjarri.** Në këtë mënyrë, ai sjell një argument të fortë për zbatimin e programeve efikase dhe të posaçme të parandalimit, sidomos të atyre që fokusohen të meshkujt e rinj në moshë.
- Thekson nevojën për rritjen e pjesëmarrjes së grave, agjencive të barazisë gjinore dhe organizatave të grave në zhvillimet dhe hartimin e politikave për kontrollin e armëve.** Integrimi i perspektivës gjinore në kontrollin e armëve të vogla nënkupton pranimin e faktit se kontrolli i armëve të vogla ndodh zakonisht në institucione të mbizotëruara ndjeshëm nga burrat, gjë që mund të ndikojë te rezultatet e politikave. Krahas kësaj, ai pranon kontributet e rëndësishme të grave në përpjekjet për kontrollin e AVL-ve dhe nënvizon rëndësinë e përfaqësimit të ekuilibruar të grave dhe burrave si një parakusht për kontrollin e armëve me përgjegjshmëri gjinore. Në këtë mënyrë, integrimi i perspektivës gjinore kontribuon gjithashtu në angazhimet më të gjera për barazinë gjinore, të cilat marrin parasysh pjesëmarrjen e plotë dhe domethënëse të grave në të gjitha sferat e jetës sociale, si një parakusht për barazinë gjinore dhe zhvillimin në tërësi.
- Lehtëson konvergencën midis kuadrove për kontrollin e armëve të vogla dhe për barazinë gjinore, veçanërisht me Axhendën për gratë, paqen dhe sigurinë.** Sikurse është konstatuar, çarmatimi dhe kontrolli i armëve konvergojnë me Axhendën për gratë, paqen dhe sigurinë, në të katër shtyllat e saj të ndërlidhura, pra pjesëmarrja, parandalimi, mbrojtja dhe mbështetja e rikuperimi.²² Për më tepër, integrimi i aspekteve gjinore në kontrollin e armëve forcon ndërlidhjen midis gjinisë, sigurisë dhe zhvillimit, si dhe rrit konvergencën praktike ndërmjet OZhQ 5 - Barazi gjinore (veçanërisht, të synimit 5.2 për eliminimin e dhunës kundër grave dhe synimit 5.5 për pjesëmarrjen e plotë dhe efektive të grave) dhe OZhQ 16 - Paqe dhe drejtësi, institucione të forta (veçanërisht, të synimit 16.4 për zvogëlimin e ndjeshëm të prurjeve të paligjshme financiare dhe armëve).
- Së fundi, përmirëson qasjen gjithëpërfshirëse dhe holistike ndaj kontrollit të armëve, në të cilën barazia gjinore nuk është thjesht një element “shtesë”, por është pjesa thelbësore** që duhet të merret plotësisht në konsideratë në mënyrë që përpjekjet për kontrollin e armëve të jenë efikase dhe të kontribuojnë në ruajtjen e paqes. Sikurse u përmend më lart, integrimi i perspektivës gjinore në kontrollin e armëve shton një dimension të ri mënyrës se si kuptohet problemi, i cili shpesh nuk vihet re edhe pse ka një ndikim të konsiderueshëm në efikasitetin e ndërhyrjeve.²³ Në këtë mënyrë, integrimi i perspektivës gjinore përmirëson sigurinë dhe mirëqenien e grave dhe burrave, si dhe ofron instrumentet dhe masat për t'i bërë komunitetet më të qëndrueshme ndaj efekteve shkatërrimtare të dhunës me armë.

Sfidat dhe planifikimi i së ardhmes

Ndonëse analiza e lartpërmendur ka dokumentuar progresin e konsiderueshëm të arritur në nivel legjislacioni dhe politikash lidhur me integrimin e aspekteve gjinore në kontrollin e armëve në Ballkanin Perëndimor, ajo ka shfaqur edhe sfidat e hasura gjatë zbatimit të angazhimeve ekzistuese. Analiza ka theksuar se pavarësisht rritjes së rëndësishme së integrimit të aspekteve gjinore në kontrollin e armëve, sidomos në nivel politikash, institucionet hasin shpeshherë vështirësi në zbatimin e këtyre angazhimeve në praktikë dhe në integrimin e perspektivës gjinore në veprimtaritë e tyre të përditshme. Në këtë aspekt, përpjekjet e ardhshme duhet të mbështesin në veçanti institucionet për integrimin e aspekteve gjinore në nivel operacional dhe, kështu, të tregojnë me vendosmëri vlerën praktike që u jep përpjekjeve për kontrollin e armëve. Këto veprime kanë nisur të zbatohen tashmë në Ballkanin Perëndimor²⁴ dhe përfshijnë, për shembull, zhvillimin e instrumenteve praktike me ndjeshmëri gjinore për miratimin e lejeve për armë zjarri dhe të procedurave për vlerësimin e duhur të rreziqeve dhe parandalimin e përdorimit të armëve të zjarrit në dhunën në familje. Për të përmirësuar më tej integrimin e aspekteve gjinore në nivel operacional, do të hartohen udhëzime për mbledhjen dhe analizimin e të dhënave me ndjeshmëri gjinore për Njësitë Qendrore për Armët e Zjarrit²⁵, të cilat do të shoqërohen me trajnimet e duhura. Për më tepër, strategjitë praktike për integrimin e qëndrueshëm të aspekteve gjinore në kontrollin e armëve do të eksplorojnë dhe diskutohen më tej me politikëbërësit dhe vendimmarrësit.

Për ta realizuar këtë, është e nevojshme që të përmirësohet më tej zbatimi i strategjive praktike për integrimin e aspekteve gjinore dhe shkëmbimi i praktikave të mira²⁶ që kanë rezultuar të vlefshme dhe që kanë mundur të arrijnë zhvillime pozitive. Kjo lidhet veçanërisht me ngritjen e kapaciteteve të drejtuesve të lartë dhe të përfaqësuesve të institucioneve përkatëse nëpërmjet trajnimeve, përmirësimit të mbledhjes së të dhënave dhe hulumtimeve, për të garantuar ekzistencën e një baze me evidenca për politikëbërësit. Për më tepër, duhen bërë përpjekje të vazhdueshme në mënyrë që të dëgjohet zëri i grave gjatë zhvillimit të opsioneve të lidhura me politikën.

Instrumentet ekzistuese për analizën gjinore të legjislacioni dhe politikave përkatëse shërbejnë si udhëzues mjaft të vyer për monitorimin dhe vlerësimin e progresit. Së fundi, por jo për nga rëndësia, është e nevojshme të garantohet bashkëpunimi dhe shkëmbimi i vazhdueshëm midis komuniteteve të barazisë gjinore dhe kontrollit të armëve, sidomos në kuadër të rritjes së sinergjisë me Axhendën për gratë, paqen dhe sigurinë, gjë që praktikisht duhet të lehtësojë integrimin e perspektivës gjinore në kontrollin e armëve të vogla.

Shënime në fund të tekstit

1. Dragan Bozanic është një Specialist për Hulumtimet dhe Çështjet Gjinore pranë UNDP SEESAC, email: dragan.bozanic@undp.org. Falënderime: Autori dëshiron të falënderojë personat në vijim për shqyrtimin e këtij dokumenti informues dhe për komentet e dobishme rreth tij: Diego Antoni, Specialist i Politikave për Çështjet Gjinore, Qeverisjes dhe Rimëkëmbjes pranë Zyrës së UNDP-së për Mbështetjen e Politikave dhe Programeve; Leanne McKay, Këshilltare e Lartë për Çështjet Ligjore pranë Zyrës së Krizave të UNDP-së; Juliana Buzi, Specialiste për Bashkëpunimin Rajonal pranë UNDP SEESAC; dhe Vesna Cíprus, Këshilltare e Lartë për Çështjet Gjinore pranë UNDP SEESAC.
2. Armë e vogël është çdo armë e transportueshme, e projektuar për përdorim individual, e cila realizon, është projektuar për të realizuar ose që mund të konvertohet lehtësisht për të realizuar qitje, për të shtyrë një plumb ose predhë me anë të një lënde plasëse. Në këtë kategori përfshihen, ndër të tjera, revolverët, pistoletat me vetëmbushje, pushkët dhe karabinat, automatikët, pushkët automatike dhe mitralozat e lehtë, si dhe pjesët, komponentët dhe municionet e tyre. Konspekti modular për kontrollin e armëve të vogla, Mosaic 01.20, Versioni 1.5, 2018-04-30. f.23. Në këtë dokument informues, termat armë të vogladhearmë zjarripërdoren në mënyrë të këmbyeshme.
3. Farr, Vanessa, 2006, "Analiza Gjinore si një instrument për negociatorët shumëpalësh në kontekstin e armëve të vogla" (Gender Analysis as a tool for multilateral negotiators in the small arms context). Çarmatimi si veprim humanitar: Nga pikëpamja në praktikë (In Disarmament as Humanitarian Action: From Perspective to Practice), redaktuar nga John Borrie dhe Vanessa Martin Randin, Gjenevë, UNIDIR (Instituti i Kombeve të Bashkuara për Studimet rreth Çarmatimit, Gjenevë) f. 111
4. Shihni, për shembull, Raportin "Për armët e vogla dhe të lehta", të Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara (30 shtator 2021), S/2021/839.
5. Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, Raporti i Sekretarit të Përgjithshëm për tregtinë e jashtëligjshme të armëve të vogla dhe të lehta në të gjitha aspektet e saj (4 tetor 2016), A/71/438-A/CONF.192/BMS/2016/1.
6. Komisioni kombëtar i AVL-ve është një organ kombëtar ndërinstitucional, i cili është përgjegjës për hartimin e politikave, koordinimin, zbatimin dhe monitorimin e përpjekjeve për të trajtuar të gjitha çështjet që lidhen me AVL-të brenda territorit të vendit. Në varësi të rajonit dhe procesit, Komisionet Kombëtare të AVL-ve njihen ndryshe edhe si Njësitë Qendrore Kombëtare (NJQK), Komitetet Kombëtare për Koordinimin e AVL-ve dhe/ose Agjencitë për Koordinimin e AVL-ve. UNDP, 2008, Udhëzime—Ngritja dhe funksionimi i Komisioneve Kombëtare të Armëve të Vogla dhe të Lehta (How to guide—The establishment and functioning of national small arms and light weapons commissions), f. 2.
7. Cukier, Wendy dhe James Cairns, 2009, "Gjinia, qëndrimet dhe rregullimi i armëve të vogla: Hapësira për veprim (Gender, attitudes and the regulation of small arms: Implications for action)". Armët kundër gjinisë: Ndikimet gjinore të armëve të vogla dhe të lehta (In Sexed Pistols: The Gendered Impacts of Small Arms and Light Weapon), redaktuar nga Vanessa Farr, Henri Myrntinen dhe Albrecht Schnabe, Tokio: United Nations University Press.
8. Gjinia dhe AVL-të në Evropën Juglindore—Problematikat kryesore dhe përgjigjet nëpërmjet politikave (Gender and SALW in South East Europe—Main concerns and policy response), UNDP SEESAC, 2016; Anketimet për AVL-të, UNDP SEESAC, 2019; Gjinia dhe armët e vogla—Fakte të shpejta, UNDP SEESAC, 2019; Keqpërdorimi i armëve të zjarrit në dhunën në familje në Evropën Juglindore, UNDP SEESAC, 2019; Burrat dhe armët e zjarrit në Evropën Juglindore, UNDP SEESAC, 2019; Analiza e rasteve të vrasjeve të grave me armë zjarri, UNDP Serbi, 2021; Dhuna në familje dhe keqpërdorimi i armëve të zjarrit—Studim mbi praktikën e institucioneve të sistemit të drejtësisë penale në përgjigje të dhunës në familje të ushtruar nëpërmjet keqpërdorimit ose kërcënimit të keqpërdorimit të armëve të zjarrit (Domestic violence and firearms misuse—A study on the practice of institutions of the criminal justice system in response to domestic violence committed through misuse or threat of misuse of firearms), UNDP Serbi, 2021; Armët e vogla dhe të lehta, dhuna me bazë gjinore dhe dhuna në familje—Analiza e kuadrit dhe praktikës rregullatore (Small arms and light weapons, gender-based violence and domestic violence—Analysis of regulatory framework and practice), UNDP Serbi, 2021; Një pamje e panoramës së përgjithshme—Analiza e mbulimit mediatic të rasteve të keqpërdorimit të armëve të zjarrit në dhunën ndaj grave të ushtruar nga meshkujt (A portrait against a landscape—Analysis of media coverage of firearm misuse in violence against women committed by men), UNDP Serbi, 2021.
9. Ky seksion mbështetet te dokumenti "Burrat dhe armët e zjarrit në Evropën Juglindore", UNDP SEESAC, 2019.
10. UNDP SEESAC, 2006, "Armën e mbush shejtani—Kultura e përdorimit të armëve në Evropën Juglindore" (The rifle has the devil inside—Gun culture in South Eastern Europe), Beograd, f. 25.
11. Cukier, Wendy dhe James Cairns, 2009, f. 29.
12. UNDP SEESAC, 2006, "Armën e mbush shejtani—Kultura e përdorimit të armëve në Evropën Juglindore" (The rifle has the devil inside—Gun culture in South Eastern Europe), Beograd, f. 23.
13. UNDP SEESAC, 2021, Autorët e incidenteve me armë zjarri në Evropën Juglindore në vitin 2020, Raportet e Monitorimit të Dhunës me Armë - "In Focus" (botimi nr. 4).
14. Burrat dhe armët e zjarrit në Evropën Juglindore, f. 31.
15. UNDP SEESAC, 2021, Incidentet me armë zjarri në kontekstin e dhunës në familje në Evropën Juglindore në vitin 2020, Raportet e Monitorimit të Dhunës me Armë - "In Focus" (Botimi nr. 7).
16. UNDP SEESAC, 2019, Keqpërdorimi i armëve të zjarrit në dhunën në familje në Evropën Juglindore—Fakte të shpejta.
17. UNDP SEESAC. Incidentet me armë zjarri në kontekstin e dhunës në familje në Evropën Juglindore në vitin 2020, f. 6.
18. Burrat dhe armët e zjarrit në Evropën Juglindore, f. 37.
19. UNDP SEESAC, 2016, Gjinia dhe AVL-të në Evropën Juglindore—Problematikat kryesore dhe përgjigjet nëpërmjet politikave (Gender and SALW in South East Europe—Main concerns and policy response).
20. Për një përmbledhje të detajuar të Programit të trajnimit për aspektet gjinore dhe të zbatimit të tij në Suedi, referojuni dokumentit të hartuar nga Dr. Louise Olsson dhe Kapitene Anna Björsson, Trajnimi i liderëve mbi aspektet gjinore: Programi suedez i trajnimit për aspektet gjinore (Gender Training for Leaders: The Swedish Gender Coach Program), Instituti i Xhorxhtaunit për Gratë, Paqen dhe Sigurinë, Uashington, DC, 2017.
21. Për detaje të mëtejshme shihni "Forcimi i bashkëpunimit rajonal për integrimin e aspekteve gjinore në reformën në sektorin e sigurisë në Ballkanin Perëndimor (Strengthening of Regional Cooperation on Gender Mainstreaming in Security Sector Reform in the Western Balkans)" dhe "Barazi gjinore në policim (Gender Equality in Policing)".
22. UNODA, Manuali i trajnimit për integrimin e aspekteve gjinore në kontrollin e armëve të vogla, (i pabotuar ende).
23. UNDP SEESAC, 2016, Gjinia dhe kontrolli i AVL-ve—Kuadrot ligjore dhe të politikave në EJT.
24. Për më shumë detaje shihni: UNDP SEESAC. Të ecim përpara: Integrimi i aspekteve gjinore në kontrollin e AVL-ve në nivel operacional (Moving forward: Taking mainstreaming of gender in SALW control to the operational level). Marrë nga <https://www.seesac.org/News/1/Moving-forward-Taking-mainstreaming-of-gender-in-SALW-control-to-the-operational-level/>
25. Për më shumë detaje rreth Njësisë Qendrore për Armët e Zjarrit, shihni "Udhëzime për ngritjen e një Njësie Qendrore për Armët e Zjarrit", UNDP SEESAC, 2020.
26. Në vitin 2020, SEESAC bashkëpunoi me Zyrën e Kombeve të Bashkuara për Çështjet e Çarmatimit (UNODA) dhe ofroi një program gjithëpërfshirës trajnimi mbi integrimin e aspekteve gjinore në kontrollin e armëve të vogla, për stafin e Qendrës Rajonale të Çarmatimit të Kombeve të Bashkuara për Paqen dhe Çarmatimin në Azi dhe Paqësor (UNRCPD), stafin e Qendrës Rajonale të Çarmatimit të Kombeve të Bashkuara për Paqen dhe Çarmatimin në Afrikë (UNREC) dhe stafin e Qendrës Rajonale të Çarmatimit të Kombeve të Bashkuara për Paqen dhe Çarmatimin në Amerikën Latine dhe Karaibe (UNLIREC).

E drejta e autorit © UNDP 2022 Të gjitha të drejtat të rezervuara.

Pikëpamjet e shprehura në këtë botim janë pikëpamjet e autorëve dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht ato të Kombeve të Bashkuara, duke përfshirë të UNDP-së, apo të shteteve anëtare të Kombeve të Bashkuara.

